

PRILL - DHJETOR 2019

RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA



RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA

PRILL - DHJETOR 2019

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

Hulumtues dhe autorë:

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

Prishtinë, shkurt 2020



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajë mbi të! Frymëzona me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Definime.....	7
Hyrje.....	8
Legjislacioni.....	9
Procedurat e njohjes.....	9
Vendimet e NARIC KOSOVA.....	10
Sfidat e Qendrës NARIC Kosova.....	16

DEFINIME

- **Njohje** - do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë (MASHT), i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj
- **Barasvlerë** - do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MASHT-it i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe bën krahasueshmërinë me nivelin e diplomave dhe fushës studimore përkatëse në vend
- **Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC - National Academic Recognition and Information Center)** - përbëhet nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje dhe ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe ofron informata për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve tjera
- **Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj)** - është organ i cili merr vendime për njohje/barasvlerë apo mosnjohje/mosbarasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar të fushave të ndryshme studimore

HYRJE

Problematika e procesit të njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit, e cila shpeshherë është hapur si diskutim në vendin tonë, ka shtyrë ORCA-n që të fillojë monitorimin e Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova).

Raporti është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj) në NARIC Kosova, për periudhën prill – dhjetor 2019.

ORCA ka marrë pjesë në mbledhjet e mbajtura nga KShNj, si dhe ka mbajtur takime të vazhdueshme me stafin e Zyrës së Qendrës NARIC, të cilët kanë treguar për sfidat me të cilat përballen gjatë kohës së realizimit të punës së tyre.

Mungesa e një ligji të veçantë, stafi i vogël në numër, mungesa e rregullores së punës së KShNj-së, diplomat e shteteve të huaja të cilat për arsye të ndryshme mbesin në proces apo nuk arrihet t'u jepet njohje, mungesa e një databaze online, janë vetëm disa prej problemeve të cilat po e vështirësojnë funksionimin e kësaj qendre.

LEGJISLACIONI

NARIC Kosova aktualisht punon duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës¹, konkretisht me Nenin 5 *'Qasja në arsimin e lartë'*, në të cilin sqarohet se bartësit e arsimit të lartë që janë akredituar në Kosovë, duhet të këshillohen me NARIC Kosova, si dhe me Nenin 6 *'Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e Arsimit të Lartë'*, ku përmes pikës 1.6 sqarohet vendosja e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane.

NARIC-u punon duke u bazuar në *Udhëzimin Administrativ për verifikimin e dokumentacionit shkollor (Publik dhe privat) për nevojat e kandidatëve që shkollohen jashtë shtetit*², përmes të cilit rregullohet procedura e verifikimit dhe konfirmimi i saktësisë së dokumenteve shkollore.

Po ashtu, kjo qendër bazohet edhe në *Udhëzimin Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës*.³

PROCEDURAT E NJOHJES

Lëndët e universiteteve publike të rajonit dhe universiteteve në listat e rangimeve botërore, pasi marrin konfirmimin nga shteti se janë autentike dhe të vlefshme, miratohen nga stafi i Zyrës së Qendrës NARIC. Universitete në listat e rangimeve botërore konsiderohen ato që janë të ranguar lartë në Academic Ranking of World Universities (ARWU), Times Higher Education World University Ranking (THE) dhe QS World University Ranking.

Këshilli Shtetëror për Njohje, shqyrton vetëm lëndët për të cilat Qendra NARIC konstaton se duhet një ekspertizë më e thellë, ndërsa për lëndët që vijnë nga Institucionet e Arsimit të Lartë me renome botërore si dhe ato publike të rajonit, KShNJ mund t'ia delegoj kompetencat kryesuesit të KShNJ-së, që të nënshkruaj vendimin për njohje/barasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari përgjegjës i NARIC.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10210>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15228>

VENDIMET E NARIC KOSOVA

Në periudhën kohore prill – dhjetor 2019, janë marrë gjithsej 970 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ndërkohë që në proces, janë 485 lëndë të cilave ndër vite nuk u është dhënë përgjigje nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.

Vendimet e KShNj

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur gjithsej dhjetë mbledhje në datat 25 prill, 24 maj, 28 qershor, 29 korrik, 10 shtator, 4 tetor, 14 tetor, 4 nëntor, 21 nëntor dhe 26 dhjetor.

Pjesë e këtyre vendimeve, janë diplomat e fituara në Institucione të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat.

Në mbledhjen e mbajtur me 25 prill, KShNj ka njohur një diplomë të nivelit të pestë, 24 diploma të nivelit Bachelor, 26 të nivelit Master dhe gjashtë për nivelin doktoratë, e që gjithsej janë 57 diploma të njohura.

Në mbledhjen e mbajtur me 24 maj, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për dy diploma të nivelit të pestë, 22 diploma të nivelit Bachelor, 21 të nivelit Master dhe tetë të nivelit doktoratë, e që gjithsej janë 53 diploma të njohura.

Në mbledhjen e mbajtur me 28 qershor, KShNj ka njohur 16 diploma të nivelit Bachelor të studimeve, ndërkohë që nuk e ka njohur një diplomë të këtij niveli, tutje ky këshill ka dhënë vendim pozitiv edhe për 22 diploma të nivelit Master dhe për 12 të doktoratës, e që në total i bie se janë njohur 51 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur me 29 korrik, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për 21 diploma të nivelit Bachelor, 17 të nivelit Master dhe shtatë të nivelit doktoratë, pra gjithsej kanë njohur 45 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur me 10 shtator, KShNj nuk e ka njohur një diplomë të nivelit Bachelor, ndërkohë që ka njohur 19 diploma të po të njëjtit nivel, 24 të tjera të nivelit Master dhe 17 të nivelit doktoratë, e që në total i bie se është marrë vendim për 61 lëndë.

Në mbledhjen e mbajtur me 4 tetor, KShNj ka miratuar kalimin e 7 diplomave të nivelit Bachelor, 21 të nivelit Master dhe 9 të nivelit të doktoratës, pra janë njohur gjithsej 38 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur me 14 tetor, KShNj nuk i ka njohur dy diploma të nivelit Master, ndërkohë që ka njohur një diplomë në nivelin Bachelor, tri të tjera të nivelit Master, e që në total është marrë vendim për 6 lëndë.

Në mbledhjen e mbajtur me 4 nëntor, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për një diplomë të nivelit 5, 27 diplomave të nivelit Bachelor, 17 të nivelit Master dhe 12 të nivelit të doktoratës, pra janë njohur gjithsej 59 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur me 21 nëntor, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për 12 diploma të nivelit Bachelor, 12 të nivelit Master dhe 6 të nivelit të doktoratës, pra janë njohur gjithsej 30 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur me 26 dhjetor, KShNj nuk e ka njohur një diplomë të nivelit Bachelor, ndërkohë që ka njohur 14 diploma në nivelin bachelor, 19 të nivelit Master, dhe 9 të nivelit të doktoratës e që në total i bie se është marrë vendim për 48 lëndë.

Gjithsej KShNj ka marrë vendime për 441 lëndë, 4 të nivelit 5, 167 të nivelit Bachelor, 184 të nivelit Master dhe 86 të nivelit të doktoratës.


Vendimet nga stafi i Zyrës së Qendrës

Sa i përket numrit të lëndëve apo diplomave të vlerësuara nga Zyra e Qendrës NARIC dhe jo nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), për diplomat e fituara në universitete botërore dhe rajonale, vetëm gjatë periudhës prill-dhjetor të vitit 2019, numri i përgjithshëm arrin në 529.

Prej tyre, 161 diploma janë miratuar nga niveli Bachelor i studimeve, 247 nga niveli Master dhe 121 nga niveli i doktoratës.

Lëndë në listat e rangimeve botërore, si dhe ato publike të rajonit (Shqipëri-Maqedoni e Veriut), të miratuara nga stafi i Qendrës NARIC Kosova

MUAJT PRILL - DHJETOR



Të gjitha vendimet e Qendrës NARIC Kosova

Numri i përgjithshëm i diplomave të njohura dhe atyre të refuzuara për periudhën prill-dhjetor të vitit 2019, është 970.


Nga niveli i pestë janë miratuar katër diploma, nga niveli Bachelor janë miratuar 324 diploma ndërsa janë refuzuar katër të tilla.

Në nivelin Master janë miratuar gjithsej 429 diploma, ndërsa janë refuzuar dy.

Në nivelin e doktoratës, janë miratuar 207 diploma nga NARIC Kosova.

Tabela e kompletuar me të gjitha të dhënat e mësipërme

MUAJT PRILL - DHJETOR



Lëndët ende pa përgjigje

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ka gjithsej 485 diploma apo lëndë të cilat ndër vite gjenden në proces dhe se nuk u është dhënë ende përgjigje.


Numri i diplomave që janë lënë pa përgjigje, e të cilat vijnë nga shteti i Shqipërisë arrin në 64, nga shteti i Maqedonisë së Veriut janë 209 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje apo që kanë mbetur ende në proces, nga vendet e tjera, është 212.

Arsyet për mospërgjigje janë të ndryshme:

- Nuk ka përgjigje nga institucionet ku aplikantët i kanë përfunduar studimet
- Nuk ka informacion lidhur me akreditimin dhe NARIC Kosova është në pritje të përgjigjes për akreditim
- Diplomat vijnë nga institucione të disa shteteve që nuk e njohin Kosovën si shtet
- Vonesat në përgjigje nga institucionet e Turqisë
- Përgjigje të paqarta nga institucionet e Shqipërisë



Lëndët e pranuar në vazhdimësi ndër vite, të cilat janë në proces dhe nuk u është dhënë përgjigje



Pasqyrë e vendimeve të Këshillit Shtetëror për Njohje dhe stafit të NARIC Kosova

NGA KËSHILLI SHTETËROR PËR NJOHJE												NGA STAFI I NARIC	
	Prill	Maj	Gershor	Korrik	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor				Prill - Dhjetor	
	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Negativ	Pozitiv
Niveli 5	1	2					1						0
BA	24	22	16	1	21	19	1	8	1	39	14	1	161
MA	26	21	22		17	24		24	2	29	19		247
PhD	6	8	12		7	17		9		18	9		121
Total	57	53	51		45	61		44		87	43		
Total	441												529

SFIDAT E QENDRËS NARIC KOSOVA

Databaza online

Që nga shtatorit i vitit 2018, NARIC-u është duke funksionuar pa një databazë online, e cila përmban të dhëna për të gjitha lëndët që kanë pranuar, ato të cilat janë në proces dhe për ato që i kanë shqyrtuar.

Sipas udhëheqëses së këtij divizioni dhe zyrtarëve të tjerë, kjo databazë ka një vit që është djegur dhe se mungesa e saj po vazhdon t'ua vështirësojë punën, meqenëse tashmë detyrohen që për çfarëdo informacioni, kërkimin ta bëjnë në mënyrë fizike mes dokumenteve në arkivë.

Andaj, propozohet krijimi i një databaze digjitale, e cila do të mundësonte ruajtjen/arkivimin e të dhënave për njohjet/barasvlerën e diplomave ndër vite.

Databaza interaktive

Të përgatitet një dokument/databazë për sistemin e arsimit parauniversitar dhe të lartë në Kosovë (psh. cilat shkollime të arsimit të mesëm të lartë japin qasje për vazhdim të mëturjesëm; në cilat raste matura nuk është obligative etj.). Kjo lloj databaze do të publikohej në ueb të NARIC-ut dhe do të shërbente për shtetet tjera, të cilat kanë nevojë për informata rreth sistemit të arsimit në Kosovë. Kjo gjithashtu do t'ua lehtësonte procedurat studentëve kosovarë të cilët për arsye të ndryshme, i përdorin diplomat e tyre jashtë shtetit. (Lidhur me këtë pikë, të gjendet një formë e përgatitur/shembull nga shtetet tjera.)

Mungesa e stafit

Mungesa e stafit apo kapaciteteve njerëzore, sipas këtyre zyrtarëve ka vite që po ua pamundëson atyre ndjekjen apo shqyrtimin e rasteve në kohë, për shkak të vëllimit të madh të lëndëve.

Andaj propozohet që për këtë qendër, të ketë mbështetje edhe me staf profesional për kohë të caktuar (angazhimi i ndonjë eksperti me përvojë relevante në AL); Të zhvillohet komponenta e informimit akademik përmes trajnimeve (të specifikohen nevojat ndërkohë).

Ligji i veçantë

Propozohet krijimi i një ligji të veçantë që e rregullon punën në NARIC, meqenëse sipas rregullores së re të MASHT-it, NARIC nuk është pjesë e Arsimit të Lartë dhe se fushëveprimi i kësaj qendre është shumë më i gjerë, pasi që përfshinë edhe arsimin parauniversitar.

Si pasojë e mungesës së një ligji të veçantë, Gjykata e Apelit ka obliguar MASHT-in, konkretisht KShNj-në, që të zbatoj vendimin e saj për njohjen e diplomës së doktoratës të një kandidati.

Vendimi për njohjen e kësaj diplome, u nënshkrua nga KShNj, mirëpo përmes Avokaturës së Shtetit, KShNj/NARIC është ankuar në Gjykatën Supreme, meqenëse sipas tyre, vendimi për mosnjohje të asaj diplome ka qenë i bazuar.

Urdhëri nga gjykata për njohje të asaj diplome të doktoratës, vlen vetëm për këtë rast dhe se nuk mund të përdoret nga kandidatët apo rastet e ngjashme.

Rregullorja për Këshillin Shtetëror për Njohje

Krijimi i një rregulloreje për punën e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj), përmes të cilës përcaktohet mënyra e punës së këtij këshilli siç janë thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes apo votimit për lëndë, zbatimi i vendimeve dhe çështjeve tjera përkatëse.

Lëndët pezull nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri

Sfidë e NARIC KOSOVA vazhdon të mbetet edhe njohja e diplomave nga shteti i Shqipërisë.

Përgjigjet kontradiktore për diplomat e fituara në Universitetet Private të Shqipërisë, ose ndryshimi i përgjigjes nga negative në pozitive pa ndonjë arsyetim të bazuar, po vazhdon t'ia vështirësojë KShNj-së procesin për njohje të atyre diplomave.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë(MAShT) dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri(MASR), janë pajtuar që njohja e diplomave të bëhet përmes një forme të caktuar dokumenti, të cilën do ta përdorin të dyja vendet.

Në rastet kur diploma i plotësonte të gjitha kushtet për njohje sipas legjislacionit në fuqi, në njërin nga rubrikat e dokumentit të dorëzuar nga MASR shënohej “Kjo diplomë është e vlefshme në Republikën e Shqipërisë”, ndërkaq sipas NARIC-ut, Shqipëria ka ndryshuar formën njëanshëm, në të cilën tashmë po shënohet “Kjo diplomë është e vlefshme në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është shtuar rubrika “Vërejtje”, në të cilën shkruhet “MASR nuk është përgjegjëse për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në formular”.

Sipas NARIC-ut, ka disa raste për të cilat Ministria e Arsimit të Shqipërisë, para një viti ka dhënë përgjigje negative dhe pas një viti ka ndryshuar përgjigjen në pozitive për njohje të diplomës.

Kjo ka ndodhur për arsye se këtyre studentëve, u është mundësuar nga institucioni ku kanë përfunduar studimet që të ndryshojnë datën e diplomimit pa dhënë provime shtesë.

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencionit Austriak për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 **AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION**


**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministerteva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology*

